



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

Data **06.10.2023**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje kimikate dhe reagente

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kimikate për trajtimin e ujit

VLERA E FONDIT LIMIT:

3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e pesë) leke pa TVSH

Fondi limit është perlllogaritur nga Sektori i Planifikim -Raportim bazuar ne urdherin nr. 134, date 03.10.2023, ndersa kerkesat dhe specifikimet teknike jane hartuar nga Laborantja si me poshte:

Nr	Emërtimi	Specifikime teknike
1	Hipoklorit Natriumi	me përqendrim të klorit aktiv 13 - 15%
2	COD Vario LR Reagent	0 -150 mg/L Lovibond, skadenca pas 2 vitesh
3	COD Vario MR Reagent	0 -1500 mg/L Lovibond , skadenca pas 2 vitesh
4	Kompleti testues për matjen e nitrit NO2	diapazoni I matjes 0,015-0,600mg/1 NO2-N/0,05-2,00mg/1 no2 Hach LCK341
5	Kompleti testues për matjen e Nitrit mg NO3	diapazoni I matjes 0,23-13,5mg/L no3-n,1-60mg/1 NO3 Hach LCK339
6	Kompleti testues për matjen e amoniakut	diapazoni I matjes 0,05-2,000mg/1 NH4-N,0.02-2.50MG/1 NH4+HACH LCK304
7	Endo nps	Set jastek ushqyes x100 me filter membranore për ecoli Sartorius 14053-47-N



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

8	Azide nps	Set jastek ushqyes x100 me filter membranore për bakteret fekale Sartorius 14051-47-N
9	mfc nps	Komplet jastek ushqyes x100 me filter membrane per e,coli dhe enerobakteret koliforme Sartorius 14068-47-N
10	Garzë sterile	

Hipoklorit Natriumi 13-15% klor aktiv

Hipokloriti i Natriumit (NaOCL) që do të përdoret për ujin e vlerat parametrike të shprehura në Rregulloren “ Cilësia e Ujit të Pijshëm” dale nga VKM Nr. 379 Prot., datë 25/05/2016.

1. Lëndë e pastër kimikisht;
2. Lëndë me përqëndrim klor aktiv në masën 13-15 %;
3. Përbërësit dhe parametrat e hipokloritit të natriumit me 13-15% klor aktiv duhet të jenë sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore për këtë qellim;
4. Gjendja e lenget, ngjyrë e verdhë e çelët me densitet 1.13-1.24.

Ne lidhje me hartimin e kerkesave per kualifikim, ato jane hartuar sipas ndarjes se pergjegjesive te percaktuara ne Urdherit e Prokurimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UK Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2021,2022, me një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të këtij prokurimi. **Kjo Kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuara janë në përputhje me përcaktimin e nenin 43/2 të VKM nr. 285 dhe tregojnë kapacitetin financiar të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar qendrueshmërinë dhe eksperiencën e operatorëve.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43/1 të VKM 285, ku është lënë mundësi entit prokurues që të kërkojë vërtetim mbi xhiron deri në tre vitet e fundit të operatorëve ekonomik

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar për hipokloritin e natriumit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për të garantuar furnizimin në mënyrë të vazhdueshme me cilësi sipas specifikimeve teknike duhet të jepet edhe autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

2.2.3 Në rastet kur operatorët ekonomik janë vet prodhues, duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit A, për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për të garantuar furnizimin duhet që operatorët ekonomik ofertues në rastet kur janë vet prodhues të jenë të pajisur me leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

2.2.4 Ne rastet kur operatorët ekonomik janë importues, duhet të jenë të paisur me leje importi për hipoklorit natriumi, leshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi të garantuar furnizim duhet që operatorët ekonomik ofertues të jenë të pajisur me lejet përkatëse nga Ministria e Shëndetësisë në përputhje me Urdhërin nr. 202, datë 23.05.2014 të Ministrit të Shëndetësisë..

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015, për sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, të leshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara (të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Certifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për të garantuar furnizimin në mënyrë të vazhdueshme me cilësi sipas specifikimeve teknike duhet që operatorët ekonomik ofertues të jenë të certifikuar për cilësinë e furnizimeve që ofrojnë sipas standarteve ndërkombëtare.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të vertetojë se hipokloriti i natriumit është i pershtatshëm në trajtimin e ujit të pishëm, duke paraqitur fletë analize nga ISHP e cila paraqitet me rezultat mbi parametrat e hipokloritit të natriumit të bazuar në Standartin shqiptar hipoklorit natriumi S SH EN 901:2013 e cila është ekuivalente me EN 901:2013

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi paraqitja e analizave të tilla garanton që produkti që do të furnizohet është brenda standarteve.

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumenta, që vertetojnë pronesinë apo qeramarrjen për automjet të posaçëm (AUTOBOT) 10.000-12.000 lt. për transportin e hipokloritit të natriumit ose me depozita 1000 lt të certifikuar të cilat të jenë të testuara dhe të miratuara në përputhje me dispozitat e ADR sipas Ligjit Nr. 118 / 2012 PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME pasi Hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt me ADR me kodin UN1791 , ADR 1791 SOLUCION HIPOKLORIT NATRIUMI dhe klasifikohet në listën e lendeve vepruese për trajtimin e ujit të pijshëm duke paraqitur certifikatat përkatëse ADR për secilën prej tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për transportin e këtij produkti shume te rendesishem, duhen pajisje te testuara per te garantuar transport te sigurte dhe brenda parametrave te cilesise se kerkuar.

Njesia e Prokurimit